USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

KOSOVA
DEMOCRATIC
INSTITUTE

TRANSPARENCY
INTERNATIONAL
KOSOVA

# INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK 2018

## PËR KOMUNAT E KOSOVËS

MAJ 2019



TRANSPARENCA DHE
KUNDËR-KORRUPSIONI

MAJ 2019

# INDEKSI I TRANSPARENCËS NË PROKURIMIN PUBLIK 2018

## PËR KOMUNAT E KOSOVËS

COPYRIGHT © 2019. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë
Tel .: +1 (0) 248 0
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Nga: Elira Tahiri dhe Diana Metushi Krasniqi

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës - Transparency International Kosova dhe përkrahur nga USAID përmes aktivitetit të Komunave Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

# PËRMBAJTJA

**LISTA E SHKURTESAVE** .......... **8**
**HYRJE** .......... **9**
**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** .......... **10**
**RANGIMI I KOMUNAVE** .......... **14**
**METODOLOGJIA E HULUMTIMIT** .......... **16**
**LISTA E TREGUESVE** .......... **19**
**ANALIZA KRAHASUESE 2015-2016-2017-2018** .......... **25**
**SHTYLLA I: TRANSPARENCA NË PROKURIMIN PUBLIK** .......... **28**
Planifikimi i prokurimit në faqe të internetit .......... 30
Transparenca në aktivitetet tenderuese .......... 31
Njoftimet për kontratës .......... 31
Publikimi i kontratave të nënshkruara .......... 32
Publikimi i kontratave të nënshkruara .......... 35
Transparenca në ankandet publike .......... 36
Informatat për ankesat e shkallës së parë që lidhen me procesin e prokurimit publik ..........
**SHTYLLA II: TRANSPARENCA BUXHETORE** .......... **39**
Publikimi i planit të investimeve në faqen e internetit .......... 41
Publikimi i buxhetit të aprovuar në faqen e interneti .......... 42
Publikimi i ndryshimeve në ndarjet buxhetore në faqen e internetit .......... 43
Publikimi i raporteve financiare në faqen e internetit .......... 44

Publikimi i raportit vjetor përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin paraprak fiskal në faqen e internetit ........44
Publikimi i kornizës afatmesme buxhetore në faqen e internetit ........ 45
Raporti i auditorit në faqen e internetit ........ 46
Publikimi i raportit vjetor për subvencionet në faqen e internetit ........ 47
**SHTYLLA III: QASJA NË DOKUMENTET PUBLIKE........ 48**
**SHTYLLA IV: INFORMIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT ........ 51**
Hapja dhe konsultimi publik........ 53
Seancat e hapjes së tenderëve ........ 53
Publikimi i draft buxhetit për konsultime publike ........ 53
Publikimi i draft vendimeve dhe/ose agjendave për konsultim me publikun ........ 54
Dëgjimet publike ........ 54
Vizitimi i faqeve komunale të internetit nga qytetarët ........ 55
Komunikimi me komunën........ 57
Informata për ndërmarrjet komunale dhe institucionet e varura ........ 58
**SHTYLLA V: GRANTET DHE FINANCIMI ........ 59**
**SHTYLLA VI: ETIKA PROFESIONALE DHE KONFLIKTI I INTERESAVE........ 64**
**KONKLUDIME ........ 69**
**REKOMANDIME........ 70**
**SHTOJCA 1- LISTA E PYETJEVE QË U JANË DËRGUAR TË GJITHA KOMUNAVE........ 71**

“Ipsa scientia potestas est”
(‘vetë dituria është fuqi’)

FRANCIS BACON NË VITIN 1597

# LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---|---|
| **E-PROKURIMI** | Platforma elektronike e prokurimit publik |
| **IPP** | Indeksi i prokurimit publik |
| **KDI** | Instituti Demokratik i Kosovës |
| **KRPP** | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik |
| **LPP** | Ligji për prokurimin publik |
| **MAP** | Ministria e Administratës Publike |
| **MAPL** | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| **MF** | Ministria e Financave |
| **MPMS** | Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale |
| **OSHP** | Organi i Shqyrtimit të Prokurimit |
| **TI** | Transparency International |
| **TIK** | Transparency International Kosovë |
| **UA** | Udhëzimet administrative |
| **ZKA** | Zyra Kombëtare e Auditimit |

# HYRJE

Në vitet e fundit, Qeveria e Kosovës e ka përmirësuar menaxhimin dhe transparencën e shpenzimeve publike duke i përfshirë direktivat e BE-së për prokurimin publik[1] në kornizën ligjore dhe rregullative, duke e rritur pjesëmarrjen publike,[2] duke krijuar programe të trajnimit,[3] dhe duke vendosur një platformë elektronike të prokurimit.[4]

Përderisa Kosova ka rënë në rangimin e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit 2018, nga vendi i 85-të në vendin e 93-të, përmirësime të dukshme janë vërejtur në prokurimin publik, si në politika ashtu edhe në praktikat e transparencës. Heqja e dispozitave ligjore që kanë penguar publikimin e planeve të prokurimit nga të gjitha institucionet publike, pasuar me futjen e ndryshimeve legjislative që e bëjnë publikimin e të gjitha kontratave në platformën e prokurimit elektronik (E-prokurimit) të detyrueshëm për të gjitha institucionet, kontribuuan për një nivel më të lartë të transparencës në shpenzimet publike. Vendosja e portalit të transparencës nga Ministria e Financave[5], ku publikohen raportet e planifikimit të buxhetit dhe shpenzimeve për të gjitha institucionet, ishte një hap tjetër për rritjen e transparencës së shpenzimeve publike.

Përderisa institucionet vazhdojnë të angazhohen progresivisht në shpalosjen e informatave të prokurimit publik, ato duhet të arrijnë rezultate në llogaridhënie dhe qeverisje të mirë.

Përmes publikimit të rregullt të Indeksit të Transparencës, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/Transparency International Kosova (TIK) vazhdon të hedhë dritë mbi aktivitetet komunale të prokurimit dhe në këtë mënyrë t'i stimulojë institucionet për ta përmirësuar cilësinë e shërbimeve që u ofrohen qytetarëve. Qëllimi i këtij indeksi është informimi i qytetarëve për nivelet e transparencës dhe efikasitetit me të cilat qeveritë lokale mund të ofrojnë mallra, punë dhe shërbime dhe inkurajimi i institucioneve për të kryer prokurime më efikase dhe transparente. Përmirësimi i transparencës dhe qasja në informata rreth shpenzimeve publike u mundëson qytetarëve ta kuptojnë se si shpenzohen tatimet e tyre.

Në vitin 2018, KDI e ka pasuruar indeksin duke futur dy shtylla të reja dhe 24 tregues shtesë. Qëllimi i këtij ndryshimi ishte matja e transparencës në një mënyrë gjithëpërfshirëse, si përfshirja e raporteve vjetore, informimi dhe pjesëmarrja publike, grantet dhe financimi, etika profesionale dhe konflikti i interesit. Këto ndryshime janë bërë në bashkëpunim me përfaqësuesit e qeverisë lokale, ekspertët dhe shoqërinë civile.

---

1 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

2 Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Aktet nënligjore: Rregullorja (QK) nr. 01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve komunale, Rregullorja nr. 02/2017 për sistemin e menaxhimit të performancës komunale, Rregullorja (MAPL) nr. 01/2017 për procedurën për hartimin dhe publikimin e akteve komunale; Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencave të komiteteve konsultative në komuna; Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 01/2015 për transparencën në komuna

3 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 25

4 E-Procurement; FreeBalance, http://opendata.rks-gov.net, etj.

5 Portali i Transparencës: https://ptmf.rks-gov.net

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2018, Kosova shënoi progres të dukshëm në transparencën e prokurimit publik si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal të qeverisë. Më në fund u trajtuan sfidat teknike dhe politike të cilat i pengonin qeveritë lokale që të japin plotësisht rezultate në transparencë në vitin 2017, si funksionalizimi i faqeve të reja komunale të internetit dhe përfundimi i zgjedhjeve lokale.

Në vitin 2018, vëllimi i përgjithshëm i njoftimeve për kontratë të publikuara dhe njoftimeve për dhënien e kontratave të publikuara në faqet e internetit të komunave u rrit për 28% krahasuar me vitin 2017; megjithatë, arritja më e madhe e vitit 2018 ishte publikimi për herë të parë i kontratave aktuale në platformën e E-prokurimit. Dispozita administrative që e përkrah kërkesën që të gjitha institucionet ta bëjnë publikimin e kontratave në platformën e E-prokurimit u shpall përmes udhëzimeve të ndryshuara të KRPP-së në shtator 2018, megjithatë deri në fund të vitit, edhe 23 nga komuna tashmë vullnetarisht publikonin kontratat e tyre në faqet e tyre të internetit.

Ndonëse presioni i organizatave të shoqërisë civile në komuna për kontrata të hapura ishte konsistent gjatë disa viteve të fundit, ky zhvillim dramatik u arrit vetëm kur kryetarët e komunave vendosën ta fusin në përdorim këtë praktikë si mënyrë për ta treguar përkushtimin e tyre personal për një qeverisje më transparente. Në një periudhë shumë të shkurtër dhe si rezultat i konkurrencës pozitive, shumica e komunave të Kosovës filluan t'i publikonin kontratat e tyre në faqet e internetit të komunave, jo vetëm në platformën e E-prokurimit.

Përveç kësaj, pas rekomandimeve të Indeksit të Prokurimit Publik 2018, 11 komuna kanë filluar t'i publikojnë vendimet e tyre të shkallës së parë lidhur me ankesat për oferta ose ankesat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë. Gjithashtu, 24 komuna i kanë publikuar planet e tyre të prokurimit dhe 20 komuna i kanë publikuar raportet vjetore të prokurimit për vitin e kaluar në faqet e tyre të internetit. Vendosja në dispozicion e dokumenteve publike si planet e prokurimit, njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënien e kontratës, kontratat dhe raportet vjetore të prokurimit u mundësojnë qytetarëve, shoqërisë civile dhe mediave që ta analizojnë performancën e komunës në fushën e prokurimit publik.

Përderisa aktivitetet e prokurimit dhe ankandet publike tani janë gjithnjë e më transparente dhe kur KRPP-ja është në gjendje ta ushtrojë një nivel të rritur të mbikëqyrjes për të dy aktivitetet në krahasim me vitet e kaluara, KDI i ka bashkuar këto aktivitete në një shtyllë. KDI e vlerëson nivelin aktual të transparencës së komunave të Kosovës në prokurimin publik (duke përfshirë ankandet publike) si 50% - një rritje e konsiderueshme prej 28% nga viti i kaluar (22%).

Një fushë tjetër e performancës pozitive në nivel komunal është shkalla e përgjigjeve që komunat e kanë demonstruar ndaj kërkesave zyrtare për qasje në dokumente publike - një përqindje e përgjigjes prej 78%. Kjo rritje në përgjegjshmëri plotësohet me një rënie të përgjithshme të numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike pasi që qytetarët ose hulumtuesit janë në gjendje të kenë qasje në dokumente online përmes platformës së E-prokurimit ose përmes faqeve të internetit të komunave; komunat kanë parë 59 kërkesa më pak për qasje në informata në krahasim me vitin paraprak.

KDI vërejti gjithashtu një rritje të transparencës buxhetore për 16%, një rritje nga 47% në 2017 në 63% në 2018. Kjo rritje i atribuohet publikimit të buxhetit (24 komuna), ndryshimeve në buxhet (29 komuna), planit të investimeve (23 komuna), raporteve tremujore të shpenzimeve (28 komuna), raportit përmbledhës për buxhetin e komunës për

vitin paraprak fiskal (27 komuna), kornizës afatmesme buxhetore (28 komuna), dhe raportit të auditimit komunal (22 komuna).

Në vitin 2018, KDI filloi matjen e tetë treguesve që kanë të bëjnë me informimin dhe pjesëmarrjen e publikut. Rezultatet tregojnë se të gjitha komunat i kanë të hapura seancat për hapjen e tenderëve për të gjithë qytetarët, ndërsa 22 komuna i kanë publikuar parashikimet buxhetore dhe e kanë hapur këtë proces deri në konsultimin publik. Përveç kësaj, 19 komuna i kanë publikuar në faqet e tyre të internetit draft vendimet e tyre për investimet komunale, duke përfshirë agjendat, dhe 36 komuna kanë dhënë mjetet për komunikim elektronik përmes adresave të e-mailit ose kutive të komunikimit në modulin e kontaktit.

Në vitin 2018, KDI filloi edhe matjen e transparencës në grante dhe financim. Sipas rezultateve të kësaj mase, 32 komuna i publikojnë thirrjet për grante në faqet e tyre të internetit dhe 22 komuna i publikojnë rezultatet e dhënies së granteve. Si rekomandim i Indeksit të Prokurimit Publik 2018, 12 komuna në vitin 2018 filluan t'i publikonin rregulloret për dhënien e granteve dhe 10 komuna filluan të publikonin informata mbi procesin e vlerësimit për këto grante.

Në vitin 2018, KDI shtoi një shtyllë të re në Indeksin e Prokurimit Publik me qëllim matjen e mekanizmave institucionale lokale për ta promovuar etikën profesionale dhe për t'i ulur konfliktet e interesit. Pikët mesatare bazë për komunat e Kosovës në vitin 2018 ishin 58%. Vetëm pesë komuna kishin kodet e tyre të etikës; 33 komuna të tjera vepronin sipas kodit të etikës për të gjithë shërbyesit civilë. 27 komuna raportojnë se kanë vendosur instrumente për raportimin dhe trajtimin e sjelljeve jo-etike, diskriminimit dhe konfliktit të interesit, ndërsa 30 komuna e kanë publikuar në faqen e tyre të internetit përkatësinë politike të anëtarëve të tyre të Kuvendit.

Ndonëse është vërejtur një përmirësim i dukshëm në lidhje me transparencën, ende ekzistojnë fusha për përmirësim në menaxhimin e financave publike, duke përfshirë edhe përmes aktiviteteve të prokurimit publik në nivel komunal. Ndërsa shumica e komunave i publikojnë të gjitha dokumentet kryesore që kanë të bëjnë me prokurimin publik siç kërkohet, në vitin 2019 ato duhet të përqendrohen në përmbushjen e të gjitha kërkesave në këtë shtyllë, siç janë publikimi i raporteve vjetore, vendimet mbi ankesat e shkallës së parë dhe informatat mbi institucionet qendrore dhe rregullative. Aktualisht, vetëm Prishtina i ka marrë 30 nga 30 pikë të plota në këtë shtyllë. Në të njëjtën kohë, KDI ka vërejtur se janë tetë komuna që ende nuk e publikojnë asnjë dokumentacion lidhur me prokurimin publik.

Në fushat e transparencës buxhetore, komunat duhet të vazhdojnë ta përmirësojnë performancën e tyre, veçanërisht në lidhje me publikimin e informatave mbi subvencionet, planet e investimeve, raportet përmbledhëse vjetore dhe raportin e auditorit.

Në vitin 2019, KDI pret që të gjitha komunat t'i përgjigjen kërkesave për qasje në dokumente dhe informata publike, dhe ne gjithashtu u rekomandojmë të gjitha institucioneve lokale që të fillojnë të publikojnë informata në lidhje me ndërmarrjet publike komunale në mënyrë proaktive në faqet e tyre të internetit. Edhepse disa komuna i shfrytëzojnë shërbimet nga ndërmarrjet rajonale komunale, qytetarët e tyre janë në kontakt të përditshëm me këto shërbime dhe do të ishte praktikë e mirë për komunat që të japin informata për qytetarët në lidhje me atë se si ato funksionojnë dhe kush është përgjegjës për to. E njëjta gjë pritet edhe në lidhje me grantet dhe financimet, veçanërisht në lidhje me publikimin e rregulloreve për dhënien e granteve dhe proceset e vlerësimit.

Kur është fjala për konfliktet e interesit, ne rekomandojmë që komunat të ndjekin shembujt nga komunat e Prishtinës, Pejës, Gjakovës, Gjilanit dhe Vushtrrisë për ta zhvilluar Kodin e Etikës individual të komunës dhe për t'i publikuar planet e tyre të integritetit të komunës në platformat e tyre. Mbetet shqetësuese që 11 komuna ende nuk kanë instrumente për raportimin dhe trajtimin e sjelljeve jo-etike, diskriminimit dhe konflikteve të interesit.

# TRANSPARENCA E PËRGJITHSHME NË GJASHTË SHTYLLA



# KOMUNAT ME RRADHITJEN MË TË LARTË









# RANGIMI I KOMUNAVE

Tabela e mëposhtme tregon pikët e fituara nga secila komunë, për secilën nga shtyllat e matura:

| Komuna / shtylla | | Shtylla I - Prokurimi publik (përfshirë ankandet publike) | Shtylla II - Trans-parenca Buxhetore | Shtylla III - Qasja në dokumentet publike | Shtylla IV - Informimi dhe pjesëmarrja e publikut | Shtylla V - Grantet dhe financimi | Shtylla VI - Etika profesionale dhe konfliktet e inter-esit | PIKË TË PËRG-JITHSHME PËR KOMUNË |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pikë maksimale** | | 30 | 25 | 10 | 15 | 10 | 10 | **100** |
| 1 | Prishtinë | 30 | 25 | 10 | 15 | 10 | 10 | **100** |
| 2 | Vushtrri | 28.64 | 25 | 10 | 12.5 | 7.5 | 10 | **93.64** |
| 3 | Mitrovicë | 26.18 | 25 | 10 | 13.75 | 8.75 | 8.75 | **92.43** |
| 4 | Lipjan | 28.64 | 25 | 10 | 10 | 10 | 8.75 | **92.39** |
| 5 | Ferizaj | 23.73 | 25 | 7.25 | 12.5 | 7.5 | 8.75 | **84.73** |
| 6 | Drenas | 25.5 | 18.75 | 10 | 10 | 7.5 | 8.75 | **80.50** |
| 7 | Kaçanik | 18.27 | 18.75 | 10 | 10 | 10 | 8.75 | **75.77** |
| 7 | Pejë | 15.14 | 21.88 | 10 | 8.75 | 10 | 10 | **75.77** |
| 9 | Rahovec | 25.23 | 18.75 | 10 | 10 | 5 | 6.25 | **75.23** |
| 10 | Gjakovë | 18.82 | 21.88 | 7.25 | 10 | 7.5 | 7.5 | **72.95** |
| 11 | Klinë | 24 | 21.88 | 7 | 6.25 | 5 | 8.75 | **72.88** |
| 12 | Shtime | 19.91 | 18.75 | 10 | 10 | 5 | 8.75 | **72.41** |
| 13 | Gjilan | 19.77 | 18.75 | 10 | 11.25 | 5 | 7.5 | **72.27** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Hani i Elezit | 21.41 | 21.88 | 10 | 10 | 5 | 3.75 | **72.04** |
| 15 | Kamenicë | 20.45 | 21.88 | 10 | 6.25 | 5 | 3.75 | **67.33** |
| 16 | Fushë Kosovë | 16.64 | 21.88 | 10 | 7.5 | 5 | 6.25 | **67.27** |
| 17 | Istog | 16.91 | 18.75 | 10 | 7.5 | 5 | 6.25 | **64.41** |
| 18 | Malishevë | 13.91 | 18.75 | 7 | 8.75 | 5 | 8.75 | **62.16** |
| 19 | Prizren | 20.86 | 9. | 10 | 7.5 | 7.5 | 6.25 | **61.49** |
| 20 | Podujevë | 5.59 | 21.88 | 7.25 | 8.75 | 7.5 | 8.75 | **59.72** |
| 21 | Viti | 9.55 | 17.19 | 7.5 | 8.75 | 10 | 6.25 | **59.24** |
| 22 | Suharekë | 13.64 | 15.63 | 7.5 | 7.5 | 5 | 6.25 | **55.52** |
| 23 | Skenderaj | 8.18 | 18.75 | 10 | 7.5 | 5 | 3.75 | **53.18** |
| 24 | Deçan | 18.27 | 9. | 10 | 6.25 | 5 | 3.75 | **52.65** |
| 25 | Obiliq | 8.18 | 15.63 | 6.5 | 5 | 5 | 6.25 | **46.56** |
| 26 | Junik | 11.05 | 12.5 | 10 | 3.75 | 2.5 | 6.25 | **46.05** |
| 27 | Novo Bërdë | 12 | 10.94 | 10 | 6.25 | 2.5 | 3.75 | **45.44** |
| 28 | Dragash | 16.36 | 12.5 | 0 | 5 | 2.5 | 6.25 | **42.61** |
| 29 | Graçanicë | 5.45 | 9. | 10 | 3.75 | 2.5 | 6.25 | **37.33** |
| 30 | Shtërpcë | 8.59 | 9. | 10 | 3.75 | 2.5 | 1.25 | **35.47** |
| 31 | Mamushë | 5.45 | 3.13 | 10 | 5 | 2.5 | 6.25 | **32.33** |
| 32 | Mitrovicë e Veriut | 5.45 | 3.13 | 10 | 3.75 | 0 | 3.75 | **26.08** |
| 33 | Partesh | 5.45 | 3.13 | 10 | 3.75 | 0 | 1.25 | **23.58** |
| 34 | Ranillug | 5.45 | 6.25 | 0 | 6.25 | 2.5 | 1.25 | **21.70** |
| 35 | Kllokot | 5.45 | 0 | 0 | 3.75 | 2.5 | 3.75 | **15.45** |
| 36 | Leposaviq | 5.45 | 0 | 0 | 3.75 | 0 | 3.75 | **12.95** |
| 37 | Zubin Potok | 5.45 | 0 | 0 | 2.5 | 0 | 1.25 | **9.20** |
| 37 | Zvecan | 5.45 | 0 | 0 | 2.5 | 0 | 1.25 | **9.20** |

0 KOMUNA MË SË PAKU TRANSPARENTE

KOMUNA MË TRANSPARENTE 100

# METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), kapitulli i Transparency International (TI) për Kosovën, është mbështetur në metodologjinë standarde të Transparency International gjatë viteve të fundit për ta matur transparencën e institucioneve në prokurimin publik. Në vitin 2018, KDI e ka përmirësuar metodologjinë për të përfshirë dispozita të reja ligjore në prokurimin publik në Kosovë.

Kjo metodologji e përmirësuar e vlerësimit u miratua në Kosovë përmes një procesi pjesëmarrës që përfshinte ekspertë teknikë dhe palë nga qeveria lokale[6]. Ky proces pjesëmarrës ishte informativ për komunat dhe çoi në nivele më të larta të pronësisë së komunës për procesin e vlerësimit. Rekomandimi i grupit të fokusit ishte të grupohen treguesit e të njëjtës natyrë në shtylla, duke kombinuar kështu prokurimin publik dhe ankandet në një shtyllë të vetme, siç përcaktohet më poshtë. Me rekomandimin e grupit të fokusit u shtuan dy shtylla të reja për t'i trajtuar (1) grantet dhe financimin dhe (2) etikën profesionale dhe konfliktet e interesit. Gjithashtu, dy tregues të rinj u shtuan në shtyllën e Informimit dhe Pjesëmarrjes publike në lidhje me ndërmarrjet publike dhe institucionet ndihmëse.

Për ta zbatuar metodologjinë e vitit 2018, KDI ka vlerësuar transparencën institucionale të komunave të Kosovës kundrejt 43 treguesve, të grumbulluar në gjashtë shtylla tematike. Meqenëse numri i treguesve dhe pikëve për tregues nuk japin rezultatin maksimal të kombinuar prej 100, rezultati i ponderuar është përdorur për rezultatet numerike që i mundësojnë KDI-së ta rangojë performancën bazuar në kategoritë e niveleve të ndryshme të prioriteteve ose rëndësisë. Numri i treguesve, pikët maksimale për treguesit për shtyllë dhe pesha e secilës shtyllë janë treguar në tabelën më poshtë.

6 Grupi i Fokusit u mbajt më 15.03.2018 me përfaqësues nga Qeveria, Agjencia e Donatorëve dhe Shoqëria Civile

| Shtylla | Numri i treguesve | Pikë totale të treguesve | Pikë maksimale të ponderuara sipas shtyllës |
|---|---|---|---|
| **SHTYLLA I** - Prokurimi publik (duke përfshirë ankandet publike): | 15 | 22 | 30 |
| **SHTYLLA II -** Transparenca buxhetore: | 8 | 16 | 25 |
| **SHTYLLA III -** Qasja në dokumente publike: | 4 | 4 | 10 |
| **SHTYLLA IV -** Informimi dhe pjesëmarrja e publikut**:** | 8 | 12 | 15 |
| **SHTYLLA V -** Grantet dhe financimi: | 4 | 8 | 10 |
| **SHTYLLA VI -** Etika profesionale dhe konfliktet e interesave: | 4 | 8 | 10 |
| **TOTAL** | **43** | **86** | **100** |

*** Të komunat janë informuar me email për metodologjinë e re, treguesit dhe pikëzimin[7].

7 E-mail u është dërguar të gjithë Kryetarëve të Komunave më 24 prill 2018

**Treguesit janë të ndarë në:**

1. Treguesit e Produktit - Ekzistojnë 29 tregues të produktit që e matin nëse aktivitetet dhe veprimet e planifikuara po zbatohen në të vërtetë siç është paraparë ose siç kërkohet me ligj. Këta tregues mbështeten në të dhënat e nxjerra nga burime të fuqishme dhe të verifikueshme, siç janë faqet e internetit të qeverisë komunale ose qendrore. Këta tregues marrin vlera nga 0 deri në 2 pikë, siç janë shënuar më poshtë:

0 **Pikët** - që tregojnë se nuk ka informata

1 **Pikët** – që tregojnë se informatat janë shpalosur pjesërisht

2 **Pikët** – që tregojnë se informatat janë shpalosur plotësisht

2. Treguesit e Performancës - Ekzistojnë 12 tregues të performancës që e masin cilësinë e performancës. Anketuesit e KDI-së janë mbështetur në këta tregues për t'i krahasuar të dhënat dhe për ta krijuar një përqindje të performancës. Për t'i krahasuar pikët numerike të treguesve të tjerë, këta tregues janë vlerësuar siç është përshkruar në tabelën e mëposhtme:

| KRAHASIMI I TË DHËNAVE KOMUNA KUNDREJT BURIMEVE ALTERNATIVE NË PËRQINDJE | 1 – 9 | 10-19 | 20 - 29 | 30 - 39 | 40 - 49 | 50 - 59 | 60 - 69 | 70 - 79 | 80 - 89 | 90 - 99 | 100 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PIKË** | 0.1 | 0.2 | 0.3 | 0.4 | 0.5 | 0.6 | 0.7 | 0.8 | 0.9 | 1 | 2 |

# LISTA E TREGUESVE

| Shtylla | | Treguesi | Kërkesa ligjore | Produkti | Lloji i treguesit | Vlerësimi i treguesit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| SHTYLLA I<br>Prokurimi publik (përfshirë ankandet publike) | 1 | A ka një burim tjetër zyrtar të internetit mbi prokurimin | LPP 04/L-042 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 2 | A është plani i prokurimit i publikuar në faqen e internetit | MPA AI 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 3 | A ka një listë të të gjitha organeve ekzekutive, institucioneve publike dhe organizatave të cilat i rregullojnë ose trajtojnë këshillat dhe kontestet e prokurimit | MPA AI 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 4 | A është publikuar në faqen e internetit raport vjetor i prokurimit për vitin e kaluar | MPA AI 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 5 | Njoftimet për tenderë janë të publikuar në faqen e internetit të komunës | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 6 | Njoftimet për dhënie të kontratës janë të publikuara në faqen e internetit të komunës | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 7 | Numri i njoftimeve për tender në faqen e internetit të komunës | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | A, D, W |
| | 8 | Numri i njoftimeve për tenderë në faqen e internetit të KRPP-së | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | A, D, W |
| | 9 | Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës në faqen e internetit të komunës | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | A, D, W |
| | 10 | Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës në faqen e internetit të KRPP-së | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | A, D, W |

| Shtylla | Treguesi | Kërkesa ligjore | Produkti | Lloji i treguesit | Vlerësimi i treguesit |
|---|---|---|---|---|---|
| **SHTYLLA I** Prokurimi publik (përfshirë ankandet publike) | A i publikon komuna kontratat në faqen e saj të internetit | Këta tregues janë ilustrativë, për të treguar nëse kontratat i ka publikuar komuna, dhe sa, mirëpo ata nuk vlerësohen me pikë. | P/J | Tregues i produktit | W |
| | Numri i kontratave të publikuara në faqen e internetit të komunës | | Të dhënat | Tregues sasior | W |
| | 11 Numri i njoftimeve për ankande në faqen e internetit të komunës | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | A, D, W |
| | 12 Numri i njoftimeve për ankande në faqen e internetit të KRPP-së | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | A, D, W |
| | 13 A janë të publikuara në faqen e internetit të komunës ankesat dhe vendimet e nivelit të parë për procesin e prokurimit | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 14 Numri i vendimeve/përgjigjeve për ankesat e nivelit të parë për procesin e prokurimit të publikuara në faqen e internetit | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | A, D, W |
| | 15 Numri i vendimeve/përgjigjeve të ankesave të nivelit të parë për procesin e prokurimit, informatat nga komuna | Neni 12 i UA MAPL 01/2015 | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | A, D, W |

| Shtylla | Treguesi | Kërkesa ligjore | Produkti | Lloji i treguesit | Vlerësimi i treguesit |
|---|---|---|---|---|---|
| **SHTYLLA II**<br>Transparenca Buxhetore | 1 A është plani i investimeve i publikuar në faqen e internetit | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 2 A është buxheti i publikuar në faqen e internetit | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 3 A janë ndryshimet në buxhet të publikuara në faqen e internetit | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 4 A janë raportet tremujore të shpenzimeve të publikuara në faqen e internetit | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 5 A është raporti përmbledhës i buxhetit të komunës për vitin paraprak fiskal i publikuar në faqen e internetit | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 6 A janë kornizat buxhetore afatmesme të publikuara në faqen e internetit | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 7 A është raporti i auditorit në faqen e internetit | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 8 A është raporti vjetor i subvencioneve i publikuar në faqen e internetit | Qeverisja e mirë | P/J | Tregues i produktit | D, W |

| Shtylla | Treguesi | Kërkesa ligjore | Produkti | Lloji i treguesit | Vlerësimi i treguesit |
|---|---|---|---|---|---|
| **SHTYLLA III** Qasja në dokumentet publike | 1 Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike | UA MAPL 01/2015 (neni 9) | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | I |
| | 2 Numri i kërkesave të refuzuara dhe heshtja administrative (mos-përgjigja) | UA MAPL 01/2015 (neni 9) | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | I |
| | 3 Numri i kërkesave që lidhen me prokurimin publik | UA MAPL 01/2015 (neni 9) | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | I |
| | 4 Numri i kërkesave të refuzuara lidhur me prokurimin publik | UA MAPL 01/2015 (neni 9) | Të dhënat kualitative | Tregues i performancës | I |
| **SHTYLLA IV** Informata për pjesëmarrjen e publikut | 1 A janë sesionet e hapjes së tenderëve të hapura për publikun | LPP 04/L-042 | P/J | Tregues i produktit | D, I |
| | 2 Sa shpesh e përdorin qytetarët faqen e internetit të komunës | Qeverisja e mirë | Numri | Tregues sasior | T |
| | 3 A është i publikuar draft buxheti për konsultime publike | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 4 A janë draft vendimet dhe/ ose agjendat të publikuara për konsultime me publikun | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 5 A mund t'ia dërgoni komunës një kërkesë online | MPA AI 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 6 Numri i dëgjimeve publike (minimum 2 në vit) | UA MAPL 01/2015 | Të dhënat | Tregues sasior | I, W |
| | 7 A është skema organizative për përfshirjen e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve vartëse e publikuar në faqen e internetit | MPA AI 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 8 A është legjislacioni bazë për organizimin, funksionimin dhe funksionet e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve të varura i publikuar në faqen e internetit dhe institucioneve vartëse | UA MAPL 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |

| Shtylla | | Treguesi | Kërkesa ligjore | Produkti | Lloji i treguesit | Vlerësimi i treguesit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| SHTYLLA V<br>Grantet dhe financimi | 1 | A janë rregulloret për dhënien e granteve të publikuara në faqen e internetit | Ligji nr. 03/L-040, Ligji nr. 03/L-048 UA MAP 01/2015) | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 2 | A janë thirrjet për aplikime për grante të publikuara në faqen e internetit | Rregullorja MPMS nr.02/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 3 | A janë rezultatet e dhënies së granteve të publikuara në faqen e internetit | Rregullorja MPMS nr.02/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 4 | A ka informata për procesin e vlerësimit të projekteve | Rregullorja MPMS nr.02/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| SHTYLLA VI<br>Etika profesionale dhe konflikti i interesave | 1 | A ka komuna një Kod të etikës? | Ligji 03/L-040 | P/J | Tregues i produktit | I, D |
| | 2 | A është plani i integritetit i publikuar në faqen e internetit | Ligji 03/L-040 | P/J | Tregues i produktit | D, W |
| | 3 | A ka instrument për raportimin e sjelljeve jo-etike, diskriminimit ose konfliktit të interesave | RREGULLORJA (QRK) - NR. 04/2015 | P/J | Tregues i produktit | I, D |
| | 4 | A janë përkatësitë politike ose anëtarësitë në parti politike për anëtarët e kuvendit të publikuara në faqen e internetit | MPA AI 01/2015 | P/J | Tregues i produktit | D, W |

**Vlerësimi i treguesve:**

A — konkluzion analitik i ekipit hulumtues;

D — të siguruarit e standardeve të pajtueshmërisë të miratuara nga UA MPMS 01/2015[8]

UA MAP 01/2015[9]

Ligji nr.04/L-042[10]

Ligji nr. 03/L-040[11]

Ligji nr. 03/L-048[12]

Rregullat e MPMS nr.02/2015[13]

dhe vendimin e qeverisë nr. 07/87[14]; Qeveria e Republikës së Kosovës Rregullorja Nr. 04/2015[15]

W — analizë në ueb-faqe. Hulumtimi tregon qartë që ka informata të mjaftueshme në faqen zyrtare të internetit ose në burime të tjera zyrtare të internetit;

I — përgjigje ndaj kërkesës;

T — të dhëna nga interneti.

## SQARIM

Më 13 mars 2018, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal lansoi faqet e reja të internetit për të gjitha komunat. Përderisa strukturat e faqes së internetit janë të ngjashme për të gjitha komunat, përmbajtja e secilës faqe interneti është e ndryshme, pasi nuk ka udhëzime të unifikuara për dokumentet e kërkuara që duhet të ngarkohen.

---

8 Udhëzimi administrativ (MAPL) nr. 01/2015 për transparencë në komuna: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11403

9 Udhëzimi administrativ (MAP) nr. 01/2015 për faqet e internetit të publikut: https://map.rks-gov.net/getattachment/04a69d9b-2b96-4ef2-bfc7-4c82cb8604/Udhezimi-Administrativ-(MAP)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx

10 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772

11 Ligji Nr. 03/L-040 për vetë-qeverisjen lokale: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530

12 Ligji nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524

13 Rregullat (MPMS) Nr.02/2015 për kriteret dhe procedurat për përkrahje financiare për subvencionet dhe grantet: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11129

14 Vendimi i qeverisë 07/87 për të dhëna të hapura: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_87-te_te_Qeverise_2016.pdf

15 Vendimi i qeverisë 07/87 për të dhëna të hapura: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_87-te_te_Qeverise_2016.pdf

# ANALIZA KRAHASUESE 2015–2016–2017–2018

Në vitin 2018, KDI prezantoi një metodologji të rishikuar që mat gjashtë shtylla që kanë të bëjnë me prokurimin publik, shpenzimet publike dhe instrumentet për trajtimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave në qeverinë lokale.

Megjithëse KDI e ka modifikuar metodologjinë për ta matur transparencën në prokurimin publik në nivelin e qeverisjes lokale duke prezantuar gjashtë shtylla dhe 43 tregues, prapë i ka mbajtur 19 treguesit fillestarë që janë përdorur në vitet e mëparshme, për t'i mundësuar hulumtuesve të vazhdojnë t'i matin trendët kohore kundrejt atyre 19 treguesve.

1. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike, në çdo fushë;
2. Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike, në çdo fushë;
3. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në prokurimin publik;
4. Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në fushën e prokurimit publik;
5. Publikimi i buxhetit të miratuar për vitin 2017 në faqen e internetit të komunës;
6. Publikimi i planit të prokurimit për vitin 2017 në faqen e internetit të komunës;
7. Publikimi i raportit të auditimit për vitin 2016 në faqen e internetit të komunës;
8. Numri i seancave dëgjimore publike;
9. Publikimi i raporteve financiare tremujore dhe gjysmë vjetore/ vjetore në faqen e internetit;
10. Numri i tenderëve të publikuar në faqen e internetit të komunës (njoftimet për kontratë);
11. Numri i tenderëve të publikuar në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
12. Numri i kontratave të dhëna të publikuara në faqen e internetit të komunës (njoftimet për dhënien e kontratës);
13. Numri i kontratave të dhëna të publikuara në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
14. Njoftimet për shpalljen e ankandit publik në faqen e internetit të komunës;
15. Njoftimet për shpalljen e ankandit publik në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
16. Njoftimi i fituesve të ankandit në faqen e internetit të komunës;
17. Njoftimi i fituesve të ankandit në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
18. Numri i kërkesave/ankesave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë për t'i shqyrtuar çmimet e kontratës;
19. Numri i vendimeve (përgjigjeve) për kërkesat për rishikim.

**Në vitin 2018, ka pasur një rritje mesatare prej 28% të transparencës në 19 treguesit e përmendur më lart.**

1. Në vitin 2018, ka pasur një rritje prej 30% të transparencës në prokurimin publik në krahasim me vitin 2017 (16%).
2. Përveç kësaj, ka pasur një rritje të transparencës buxhetore për 16%, nga 47% në vitin 2017 në 63% në vitin 2018.
3. Ka pasur gjithashtu një rritje prej 37% në publikimet e njoftimeve për shitjen e aseteve, nga 13% në vitin 2017 në 50% në vitin 2018.
4. Në krahasim me vitin 2017, numri i kërkesave për qasje në dokumente që kanë të bëjnë me prokurimin publik në vitin 2018 ka rënë për një total prej 59 kërkesash.

Grafiku më poshtë tregon trendët e transparencës në prokurimin publik gjatë viteve 2014-2018.

**Transparenca në prokurim krahasimi gjatë viteve 2014 - 2018**



Përveç kësaj, komunat gjithashtu treguan një rritje prej 16% të transparencës së buxhetit në krahasim me vitin 2017. Grafiku më poshtë tregon trendët e transparencës përgjatë viteve 2014-2018.




Kjo rritje e transparencës në prokurimin publik dhe shpenzimet buxhetore ka çuar edhe në një rënie të kërkesave për qasje në dokumente publike që kanë të bëjnë me prokurimin publik (sepse komunat i kanë vendosur këto dokumente në dispozicion të publikut përmes publikimit proaktiv në faqet e tyre të internetit). Ka pasur 335 kërkesa për qasje në informata në 2017, por ky numër ka rënë për 59 kërkesa në vitin 2018 në 276. Ky numër është më i ulët se numri i përgjithshëm i kërkesave në vitin 2016 (287).



# SHTYLLA I

## Transparenca në prokurimin publik

Masat e indeksit të transparencës, në Shtyllën 1, transparenca në prokurimin publik. Përafërsisht 40% e buxhetit publik të Kosovës shpenzohet përmes prokurimit publik. Por, ky proces në Kosovë shpesh përshkruhet si i prirur ndaj korrupsionit[16]

Për ta vlerësuar nivelin e transparencës në këtë Shtyllë, KDI ka matur 15 tregues[17] të lidhur drejtpërdrejt me aktivitetet e prokurimit publik në të gjitha komunat e Kosovës.

Pikët maksimale në këtë shtyllë janë 30 ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela në të djathtë tregon rangimin e komunave sipas pikëve individuale në këtë shtyllë.

Rezultati mesatar për të gjitha komunat është 50%. Ndërsa të gjitha komunat e përdorin platformën elektronike të prokurimit e-Prokurimi, ka disa dokumente të rëndësishme siç janë raportet e studimit të fizibilitetit (aty ku është e zbatueshme), raportet e vlerësimit të ofertave, planet e menaxhimit të kontratave dhe faturat të cilat nuk publikohen në platformën qendrore ose faqet lokale të internetit.

Sidoqoftë, përqindja e publikimit të planeve të prokurimit, raporteve vjetore të prokurimit për vitin paraprak, njoftimeve për tenderë, njoftimeve për dhënien e kontratës dhe njoftimeve për ankand është përmirësuar dukshëm, megjithëse ende ka hapësirë për rritje të pajtueshmërisë.

Megjithatë, për arritjen e pikëve maksimale në këtë shtyllë, komunat duhet të demonstrojnë përpjekje shtesë për të siguruar që të gjitha njoftimet për kontratë dhe njoftimet për dhënien e kontratës të publikohen në faqet e tyre të internetit, jo vetëm në platformën kombëtare të e-prokurimit, duke vazhduar me publikimin e ankesave të shkallës së parë dhe vendimeve për shqyrtimet e prokurimeve.

| # | Komuna | Pikë |
|---|---|---|
| 1 | Prishtinë | 30.00 |
| 2 | Lipjan | 28.64 |
| 2 | Vushtrri | 28.64 |
| 4 | Mitrovicë | 26.18 |
| 5 | Drenas | 25.50 |
| 6 | Rahovec | 25.23 |
| 7 | Klinë | 24.00 |
| 8 | Ferizaj | 23.73 |
| 9 | Hani i Elezit | 21.41 |
| 10 | Prizren | 20.86 |
| 11 | Kamenicë | 20.45 |
| 12 | Shtime | 19.91 |
| 13 | Gjilan | 19.77 |
| 14 | Gjakovë | 18.82 |
| 15 | Deçan | 18.27 |
| 15 | Kaçanik | 18.27 |
| 17 | Istog | 16.91 |
| 18 | Fushë Kosovë | 16.64 |
| 19 | Dragash | 16.36 |
| 20 | Pejë | 15.14 |
| 21 | Malishevë | 13.91 |
| 22 | Suharekë | 13.64 |
| 23 | Novo Bërdë | 12.00 |
| 24 | Junik | 11.05 |
| 25 | Viti | 9.55 |
| 26 | Shtërpcë | 8.59 |
| 27 | Obiliq | 8.18 |
| 27 | Skenderaj | 8.18 |
| 29 | Podujevë | 5.59 |
| 30 | Graçanicë | 5.45 |
| 30 | Kllokot | 5.45 |
| 30 | Leposaviq | 5.45 |
| 30 | Mamushë | 5.45 |
| 30 | Mitrovicë e Veriut | 5.45 |
| 30 | Partesh | 5.45 |
| 30 | Ranillug | 5.45 |
| 30 | Zubin Potok | 5.45 |
| 30 | Zvecan | 5.45 |

16 Prokurimi publik në Ballkanin Perëndimor, Gjykata Evropiane e Auditorëve, Janar 2018

17 Shih pjesën për Metodologjinë, f. X




**Grafiku në vijim paraqet situatën aktuale të përgjithshme për të gjitha komunat në këtë proces, sipas aktivitetit:**

- 24 nga komuna kanë publikuar planet e tyre të prokurimit në faqet e tyre të internetit;
- 10 nga komuna e kanë publikuar një listë të të gjitha organeve ekzekutive, institucioneve publike dhe organizatave që i rregullojnë ose trajtojnë këshillat dhe kontestet e prokurimit në faqet e tyre;
- 20 nga komuna kanë publikuar raportin vjetor të prokurimit nga viti i kaluar në faqet e tyre të internetit;
- 25 nga komuna kanë publikuar njoftimet për kontratë në faqet e tyre të internetit;
- 23 nga komuna kanë publikuar njoftimet për dhënien e kontratës në faqet e tyre të internetit;
- 19 nga komuna kanë publikuar njoftimet për shitjen e pasurive në faqet e tyre të internetit;
- 11 nga komuna kanë publikuar vendimet e autoritetit kontraktues lidhur me ankesat e shkallës së parë nga operatorët ekonomikë në faqet e tyre të internetit.

# Planifikimi i prokurimit në faqe të internetit

Përmes procesit të planifikimit të prokurimit, vendimmarrësit në komuna i përcaktojnë metodat e prokurimit dhe pritjet për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Planifikimi i prokurimit është i rëndësishëm sepse një plan i prokurimit jep listën e të gjitha kërkesave të pritura që do të blihen gjatë një periudhe kohore, përcakton afatin kohor për kryerjen e prokurimeve dhe jep vlerësime për aktivitetet e prokurimit. Në prill 2018, KRPP-ja e ka ndryshuar legjislacionin dytësor për të hequr ndalimet ligjore që e pengojnë publikimin e këtij plani. Që kur ka hyrë në fuqi ky ndryshim, 24 nga komunat publikuan planet e tyre të prokurimit në faqet e tyre të internetit.

**Planifikimet e prokurimit në ueb faqe të komunave**




**Komunat që e kanë publikuar planifikimin e prokurimit në vitin 2018**

| | |
|---|---|
| 1 | Deçan |
| 2 | Drenas |
| 3 | Ferizaj |
| 4 | Fushë Kosovë |
| 5 | Gjakovë |
| 6 | Gjilan |
| 7 | Hani i Elezit |
| 8 | Istog |
| 9 | Junik |
| 10 | Kaçanik |
| 11 | Kamenicë |
| 12 | Klinë |
| 13 | Lipjan |
| 14 | Malishevë |
| 15 | Mitrovicë e Jugut |
| 16 | Obiliq |
| 17 | Pejë |
| 18 | Prishtinë |
| 19 | Prizren |
| 20 | Rahovec |
| 21 | Shtime |
| 22 | Suharekë |
| 23 | Viti |
| 24 | Vushtrri |

# Transparenca në aktivitetet tenderuese

**Për ta vlerësuar nivelin e transparencës në tenderim, KDI i ka krahasuar gjashtë treguesit e performancës në vijim, me qëllim të ilustrimit të dallimit ndërmjet faqeve të internetit të komunave dhe njoftimeve që këto institucione i kanë publikuar në faqen e internetit të KRPP-së:**

1. Numri i njoftimeve për tenderë në faqen e internetit të komunës;
2. Numri i njoftimeve për tenderë në faqen e internetit të KRPP-së;
3. Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës në faqen e internetit të komunës;
4. Numri i njoftimeve për dhënien e kontratës në faqen e internetit të KRPP-së;
5. Numri i njoftimeve për ankand në faqen e internetit të komunës;
6. Numri i njoftimeve për ankand në faqen e internetit të KRPP-së.

## Njoftimet për kontratë

Numri i tenderëve të publikuar në faqet e internetit të komunave zakonisht është ndryshe nga numri i tenderëve të publikuar në faqen e internetit të KRPP-së. Në vitin 2018, 47% e njoftimeve për tenderët e qeverisë lokale u publikuan në faqet e internetit të komunave, që shënon një rritje prej 32% në transparencë krahasuar me vitin paraprak (15%). Nga 2,856 njoftime të tenderit që janë publikuar në platformën e-prokurimi, 1,3 prej tyre janë publikuar edhe në faqet e internetit të komunave.

**Krahasimi i tenderëve të publikuar në KRPP kundrejt ueb faqeve të komunave**



# Njoftimet për dhënien e kontratës

Lidhur me njoftimet për dhënien e kontratës, nga 2,754 njoftime të publikuara në platformën e e-prokurimit, 1,210 prej tyre janë publikuar edhe në faqet e internetit të komunave. Kjo përfaqëson 44% të njoftimeve për dhënien e kontratës. Në krahasim me vitin e kaluar (16% në 2017), viti 2018 shënoi një rritje prej 28% në transparencë në këtë tregues.

**Krahasimi i njoftimeve për dhënie të kontratave të publikuara ndërmjet krpp dhe ueb faqeve të komunave**




2018 ka shënuar një rritje prej

**28%**

të transparencës në këtë indikator

Tabelat e mëposhtme ilustrojnë nivelin e transparencës së prokurimit për të gjitha komunat e Kosovës:

**Krahasimi i publikimeve për tender për të gjitha komunat**




Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqe të komunës

Numri i tenderëve të publikuar në KRPP

**Krahasimi i publikimeve të njoftimeve për dhënie të kontratave për të gjitha komunat**




Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në ueb faqe të komunës

Numri i njoftimeve për dhënie të kontratës të publikuar në KRPP

Komunat që publikojnë më shumë se 50% të njoftimeve për kontratë dhe njoftimeve për dhënien e kontratës janë:

| # | Komuna | NJOFTIMET PËR KONTRATË | NJOFTIMET PËR DHËNIEN E KONTRATËS | PËRQINDJA E KOMBINUAR |
|---|---|---|---|---|
| | | Janar-Dhjetor 2018 | Janar-Dhjetor 2018 | |
| 1 | Prishtina | 100% | 100% | 100% |
| 2 | Vushtrri | 100% | 100% | 100% |
| 3 | Peja[18] | 100% | 98% | 99% |
| 4 | Gjilan | 98% | 95% | 97% |
| 5 | Dragash | 99% | 95% | 97% |
| 6 | Lipjan | 94% | 100% | 97% |
| 7 | Gjakova | 93% | 75% | 84% |
| 8 | Hani i Elezit | 74% | 89% | 82% |
| 9 | Drenas | 96% | 65% | 81% |
| 10 | Klina | 73% | 74% | 74% |
| 11 | Rahovec | 75% | 68% | 72% |
| 12 | Kaçanik | 56% | 71% | 64% |
| 13 | Deçan | 71% | 50% | 61% |
| 14 | Prizren | 40% | 73% | 57% |
| 15 | Mitrovica | 52% | 51% | 52% |

18 Pasi i është tërhequr vëmendja komunës që disa njoftime nuk janë publikuar në faqen e internetit, më 14 janar 2019 i kanë publikuar retroaktivisht të gjitha njoftimet që mungonin. Me qëllim që të vlerësohet gatishmëria e tyre për t'i publikuar këto dokumente, këto publikime janë përfshirë në këtë tabelë.

# Publikimi i kontratave të nënshkruara

Viti 2018 është shënuar me shumë nisma për ta përmirësuar nivelin e transparencës në prokurimin publik. Një nga nismat kryesore të ndërmarra nga komunat ishte publikimi vullnetarisht i kontratave të tyre të nënshkruara në faqen e internetit të komunës. Kjo iniciativë u pasua më pas me ndryshime në legjislacionin sekondar që e bëri të detyrueshëm publikimin e kontratave të nënshkruara në e-Prokurimi, në fuqi nga 03 shtatori 2018. Edhe pas kësaj direktive, komunat vazhduan ta ndjekin trendin e publikimit të kontratave në faqet e internetit të komunave të tyre. Gjatë vitit 2018, 23 komuna kanë publikuar kontratat në faqet e tyre të internetit, të renditura më poshtë (në rend alfabetik):

1 Dragash
2 Drenas
3 Ferizaj
4 Fushë Kosovë
5 Gjakovë
6 Gjilan
7 Hani i Elezit
8 Istog
9 Kamenicë
10 Klinë
11 Lipjan
12 Mitrovicë e Jugut
13 Obiliq
14 Pejë
15 Podujevë
16 Prishtinë
17 Prizren
18 Rahovec
19 Shtime
20 Skenderaj
21 Suharekë
22 Viti
23 Vushtrri

*Publikimi i kontratave njihet si praktikë e qeverisjes së mirë, por nuk vlerësohet në indeks.

# Transparenca në ankandet publike

Në Kosovë, numri i ankandeve publike është mjaft i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të prokurimeve publike. Artikujt e shitur përmes ankandeve nuk kanë vlerë të lartë monetare; megjithatë, publikimi i këtyre aktiviteteve në faqet e internetit të komunave është kërkesë ligjore e Ligjit Nr. 04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme në komunë.

Përveç kësaj, procedurat për njoftimet dhe dhënien e ankandit publik rregullohen përmes legjislacionit sekondar për prokurimin publik dhe për këtë arsye kërkohet edhe publikimi i tyre në faqen e internetit të KRPP-së.

**Për ta matur nivelin e transparencës në këtë proces, Indeksi i krahason dy treguesit e mëposhtëm:**

1. Numri i njoftimeve për ankand në faqen e internetit të komunës nga janari deri në dhjetor 2018;

